



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202400171/2

Tiranë ___/___/2024

Lënda: Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisaratin e Policisë nr.3,
Tiranë.

Drejtuar: Z. Tonin VOCAJ
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë

TIRANË

Për dijeni: Z. Muhamet RRUMBULLAKU
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Z. Bledar RRESHKA
Shef i Komisariatit të Policisë nr.3 Tiranë

TIRANË

I nderuar z. Vocaj,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi vizitën inspektuese që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisaratin e Policisë nr.3 në Tiranë më datë 05.02.2024.

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, seksion pranë Avokatit të Popullit, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" kreu një inspektim në ambientet e privimit të lirisë të personit në Komisaratin e Policisë nr.3 në Tiranë.

Inspektimi u krye sipas një Plani Vjetor Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi dhe znj. Gloria Çarkaxhiu me detyrë Nd/Komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. Urdhër 1720, datë 20.11. 2023 për miratimin e procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*” dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, që do të gjeni më poshtë:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të cilëve ju është privuar liria, grupi i punës u takua me shefin e Komisarariatit të Policisë nr.3 Tiranë z. Bledar Rreshka i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, shefi i komisarariatit raportoi për grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, në lidhje me masat e marra për përmirësimin e ambientit të shoqërimin, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në procedurat standarde dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Grupi i punës në vijim inspektoi ambientet e shoqërimin, të gjitha zyrat e punës të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Grupi i monitorimit, pasi mori informacionin e nevojshëm inspektoi ambientet e shoqërimin, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Në Komisariatin e Policisë nr.3 Tiranë, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe

ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera për këqyerjen e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Nga monitorimi që u bë zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë Komisariat ishte një dhomë magazinë për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale, specialistja e magazinës që ndodhej në këtë ambient mbante të gjitha provat materiale të administruara gjatë procedimeve penale nga specialistët e krimeve si dhe materialet e tjera të ndryshme sipas regjistrave përkatës të ndarë më vehte për secilën kategori.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se¹:

1. **Ishin marrë masat** për nxjerrjen e përgjegjësive për mos garantimin e kushteve dinjitoze për personat e shoqëruar dhe ndaluar pranë komisariatit nr.3, por edhe për shkeljen e të drejtave të qytetarëve e lidhur me komunikimin e kohës të së drejtave dhe zhvillimin e intervistave në ambiente të përshtatshme.
2. **Ishin marrë masat** nga Drejtori i Drejtorisë Vendore për drejtuesit e komisariatit për mos zbatimin e rekomandimeve të përsëritura të Avokatit të Popullit, dhe komunikimi në vijim të masave të marra në lidhje me to. Për këtë rekomandim me shkresën nr. 5926/3 prot., datë 31.05.2023 D.V.P. Tiranë na është bërë me dije se në vijim të këtij rekomandimi menjëherë është punuar nga drejtuesit dhe nga punonjësit e policisë në vijim për respektimin e standardeve dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. **Ishin marrë masat** për pajisjen me kartën e të drejtave të personave të shoqëruar, që në momentin e shoqërimit në mjediset e këtij komisariati.
4. **Ishin marrë masat** për plotësimin me korrektësi të “Procesverbalit të Shoqërimit”, duke shënuar orën faktike kur ata janë shoqëruar për në organin e policisë, pra orën kur personit i është privuar liria dhe jo vetëm orën kur përpilohet procesverbali përkatës nga oficeri i policisë gjyqësore.
5. **Ishin marrë masat** për plotësimin me korrektësi të rubrikës “Njoftimi i familjarëve” tek Regjistri i personave të shoqëruar dhe evidentimi i tyre në këtë regjistër.

¹ Rekomandim dt.16.06.2022 ProtK4/I21-2 Prot për inspektimin e kryer në komisariatit e policisë nr.3 Tiranë.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se **nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:**

1. **Nuk ishin marrë masa për** rikonstruksionin e dhomave të shoqërimit dhe sigurimin e kushteve të qëndrimit për të shoqëruarit sipas kapaciteteve.
2. **Nuk ishin marrë masa për** marrjen në dorëzim dhe vënien në funksionim të ambientit për intervistim e të miturve në konflikt me ligjin, dhe nxjerrjen e përgjegjësive ndaj punonjësve të cilët nuk kanë marrë masa për vënien në funksion të këtij ambienti ndonse i përfunduar prej vitesh.
3. **Nuk ishin marrë masa për** krijimin më vete të zyrës ku merren në pyetje personat e shoqëruar si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera brenda saj, për monitorimin e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.
4. **Nuk ishin marrë masat** menjëhershme për lyerjen dhe dezinfektimin e vazhdueshëm të ambienteve të këtij komisariati dhe në veçanti ambientin e dy dhomave të shoqërimit.

Në përfundim të inspektimit, u konstatua se në ambientin e shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Nr.3 në Tiranë, vazhdonin të ishin të pranishme mjaft problematika, të cilat do ti paraqesim si më poshtë:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Ambienti i shoqërimit në Komisarlatin e Policisë nr.3, Tiranë, **nuk është i ndërtuar** sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, dhe procedurës standarde dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për gratë, meshkujt madhorë dhe të miturit.²

Ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës të komisariatit dhe kishte 2 (dy) dhoma shoqërimi. Dhoma e shoqërimit për të rriturit ishte me përmasa 4x2m, ndërsa dhoma e shoqërimit për femra dhe të mitur ishte me përmasa 4x3m. Çdo dhomë kishte nga 1 stol për qëndrimin ulur të shtetasve të cilët ishin të fiksuar dhe të pa lëvizshëm.

² Pika 4 e procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”. e.1 Në njësitë vendore policore ndërtohen ambientet e shoqërimit të ndara më vete për personat madhorë, të mitur dhe femra, të cilat kanë sipërfaqe nga 16-20 m² secila.

Kapaciteti i deklaruar i dhomave ishte për mbajtjen dhe qëndrimin e deri 10 personave të shoqëruar. Nga statistikat e nxjerra nga regjistri për evidentimin e të dhënave të personave të shoqëruar, rezultoi se për periudhën Janar 2024 ishin shoqëruar gjithsej 136 persona nga të cilët 12 gra dhe 6 të mitur.

Dritarja e dhomës ku qëndronin të shoqëruarit në moshë madhore, ishte me përmasa të vogla dhe nuk krijonte mundësi për ajrim dhe ndriçim të plotë natyral, kjo dhomë kishte lagështirë të theksuar dhe në të ndihej erë e rëndë. Në vlerësimin e MKPT-së ishte i pamundur qëndrimi në këtë ambient.

Ndërsa, dhoma ku qëndronin shtetasit e shoqëruara femra dhe të mitur, ishte me dritare me përmasa normale që lejonte ajrimin dhe futjen e dritës natyrale.

Të dyja dhomat kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Në pjesën e jashtme, dritaret ishin të siguruara me rrjetë të hollë hekuri.

Dyert e dhomave ishin prej druri të veshura me llamarinë dhe mbylleshin nga jashtë me shul dhe çelës. Mjedisi i shoqërimit dhe ambientet e tjera të komisariatit nuk kishin sistem qendror për ngrohje.

Në Komisarlatin e Policisë nr.3 Tiranë **nuk kishte tualete të ndara më vete për gra dhe burra** sipas parashikimeve në procedurën standarde dhe tualeti i vetëm për personat e shoqëruar ndodhej në katin e dytë të këtij komisariati.

Në ambientin dhe dhomat e shoqërimit të komisariatit, ishin të instaluar kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe të dhomave në mjedisin e shoqërimit, të cilat monitoroheshin nga punonjësit e policisë, nëpërmjet kompjuterit i cili ndodhej në zyrën e informacionit. Administrimi i pamjeve filmike kryhej nga DPSH.

Në dhomat e shoqërimit nuk u konstatuan sende apo mjete të tilla, të cilat mundet të shërbenin për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar në ambientet e këtij komisariati.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në Komisarlatin e Policisë nr. 3, Tiranë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1”, sipas procedurave standarde

“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, i cili mbahej në zyrën e informacionit dhe ishte i sekretuar e i plotësuar sipas rubrikave.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, regjistri ishte i sekretuar dhe rubrikat e tij ishin plotësuar nga punonjësit e zyrës së informacionit. Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta.

Ndërkohë, përgjatë këqyrjes së këtij regjistri konstatoam se rubrika e regjistrimit mbi njoftimin e familjarëve ishte i plotësuar në mënyrë korrekte, ndryshe nga një vit më parë kur kjo rubrikë ishte e paplotësuar. Përgjatë inspektimit konstatoam se në regjistër ishte i shënuar emri i familjarit të njoftuar me numrin e telefonit përkatës, i cili identifikon familjarin që ka marrë dënimin³. Kjo procedurë bazuar në Urdhrin, nr. 938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit e përcaktuar në “Procedurën standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit ” ku në pikën a.1.2 citohet se: Regjistri i Evidentimit të Personave të Shoqëruar: Të dhënat për realizimin e të drejtës për njoftimin e familjarëve/afërmeve për shoqërimin si: emri, atësia, mbiemri dhe numri i telefonit të personit që është njoftuar për faktin e shoqërimit dhe të vendndodhjes së personit të shoqëruar, si dhe orën e njoftimit.

Në këtë komisarjat, punonjësit e policisë zbatonin detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit e çështjes përkatëse. Nga këqyrja e “Procesverbalit të Shoqërimit”, konstatoam se në këto procesverbale shoqërimi shënohej ora faktike kur ata janë shoqëruar për në organin e policisë, pra orën kur personit i është privuar liria⁴.

³ Masat mbrojtëse, veçanërisht në fazat e hershme të shoqërimit, janë thelbësore për të parandaluar abuzimet. Këto masa përfshijnë: dhënien e informacionit të të shoqëruarve për të drejtat e tyre; sigurimin e aksesit të një avokati; njoftimin e anëtarëve të familjes dhe/ose një palë të tretë për personin.

⁴ Urdhëri, nr 938 datë 24.07.2019, Procesverbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar: në pikën a.3.2 përcaktohet se – Ky procesverbal pasi plotësohet duke hedhur të gjithë të dhënat sipas përcaktimeve dhe rubrikave të përcaktuara në të, nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe nga vetë personi i shoqëruar.

Gjithashtu, komisariati kishte regjistër më vehte për evidentimin e të dhënave të të miturve në konflikt me ligjin, si dhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

Për periudhën e inspektimit nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë nga ana e personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në mjediset e këtij komisariati.

Në Komisaratin e Policisë nr. 3 në Tiranë personat e shoqëruar kishin akses në ujë pijshëm në çdo kohë ndërsa përsa i përket marrjes së ushqimit kjo realizohej vetëm nga familjarët me kërkesë të tyre.

Nga verifikimi i regjistrave të personave të shoqëruar, koha mesatare e qëndrimit në komisarimat varioje nga 1-5 orë.

Ambientet e sigurisë/kushtet e tyre dhe trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve.

Në Komisaratin e Policisë nr.3 Tiranë, nuk kishte ambiente sigurie. Personat të arrestuar/ndaluar, pasi përfundonin veprimet procedurale nga punonjësit e policisë, dërgoheshin në “Bllokun e Sigurisë Tiranë”.

Ambientet e intervistimit

Në Komisaratin e Policisë nr.3 në Tiranë, **nuk ka një dhomë më vete të monitoruar me sistemin e kamerave, që të shërbejë për intervistimin/ marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë, për të cilët ekzistojnë kushtet e përcaktuara në ligj se ka dyshime të arsyeshme që kanë kryer një vepër penale.** Gjithashtu në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit⁵: Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtime fizike apo presione psikologjike.

Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me

⁵ electronic recording of police interviews, fq,13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare.

KPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të ndaluar.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personave të shoqëruar në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.

Gjithashtu, edhe intervistimi apo marrja në pyetje e të miturve në konflikt me ligjin që shoqërohen në mjediset e këtij komisariati, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë dhe jo në ambiente të veçanta, sikurse është e parashikuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe procedurën standarde⁶. Avokati i Popullit e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se, intervistat me të miturit duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm dhe të pajisur me orënditë e nevojshme si tavolina dhe karrige, në një mjedis sa më të qetë, pa shtrëngime fizike dhe presione psikologjike. Në kushtet aktuale që ndodhen zyrat e punës të punonjësve të policisë, intervistimi i tyre mund të shkaktojë traumatizim plotësues të të miturit.

Nga inspektimi u evidentua se, në këtë komisariat ishte krijuar një ambient me dy dhoma për intervistimin e të miturve nga financimi i projektit suedez, me ambiente të ndara dhe të pajisura me orënditë e nevojshme, sipas parashikimeve ligjore. Ky investim ndonëse i përfunduar prej vitesh, nuk ishte vënë në funksionim. Intervistimi i të miturve në vazhdimësi kryhej në zyrat e punonjësve të policisë. Një konstatim ky i Institucionit të Avokatit të Popullit i cili ka rekomanduar përgjatë viteve 2020, 2021, 2022, 2023, për marrjen e masave dhe vënien në funksionim të këtyre dhomave por ngelet një rekomandim i pazbatuar.

Në përgjigjen zyrtare me shkresë Nr.5926/3 Prot dat. 31.05.2023, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë na bënë me dije se: Ambienti i financuar nga Projekti Suedez për intervistimin e të miturve në konflikt me ligjin, nuk ka qenë funksional për oficerët e trajnuar, pasi këto zyra nuk janë dorëzuar nga strukturat përgjegjëse.

Avokati i Popullit shpreh shqetësimin e thellë se ndonëse në këtë komisariat ka një investim të finalizuar prej 5 vitesh i cili është në interesin më të lartë të fëmijës,

⁶ Kreu VII. Pika 2.1/k e procedurës standarde thuhet se: “I mituri në konflikt me ligjin gëzon të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale si dhe të drejtat e posaçme të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur”. I mituri duhet të mbahet në dhoma/ambiente të ndarë nga personat madhorë dhe të ndarë nga të miturit e tjerë sipas gjinisë”.

personat e mitur vazhdojnë të merren në pyetje në dhomat e punës të punonjësve të policisë të cilat nuk plotësojnë standardet dhe bien ndesh me Kodin e Procedurës Penale si dhe të drejtat e posaçme të parashikuara në këtë Kod⁷.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Në Komisarriatin e Policisë nr.3, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kreu VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Gjatë inspektimit, u bë këqyrja e dokumentacionit që ndodhej në zyrën e informacionit ku rezultoi se, ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit”, si dhe zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të K.Pr.P, që personit të ndaluar/arrestuar duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit.

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat kërkonin ndihmë juridike, atyre ju sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Përgjatë inspektimit u konstatua se nuk kishte një listë të afishuar në ambientet e komisarriatit ku mund të evidentoheshin avokatët kryesisht, gjithashtu nuk ishte evidentuar në regjistrin e informacionit nëse avokatët kishin qenë të pranishëm. Gjithashtu kjo problematikë është trajtuar në raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

KPT-ja bën rekomandime të hartuara për të përmirësuar funksionimin në praktikë të masave mbrojtëse ligjore. Kërkohet gjithashtu veprim për të siguruar që të gjithë personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë. KPT- ja gjatë vizitës në organet e policisë së Shtetit ka konstatuar se: “Ka pretendime se oficerët e policisë kishin pranuar kërkesat e personave të shoqëruar arrestuar/ndaluar për avokat *kryesisht* vetëm pas një vonese të konsiderueshme, në mënyrë që të mund t’i pyesnin ata në mënyrë joformale për veprën e dyshuar pa praninë e një avokati”⁸.

⁷ Ligj Nr. 37/2017 Kodi I Drejtësisë Penale Për Të Mitur.

⁸ <https://rm.coe.int/1680ae233b>, fq nr.3, raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

Përgjatë inspektimit punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut.

Gjithashtu përgjatë inspektimit dhe bisedës me oficerët e policisë gjyqësore konstatuam se **prania e psikologut sigurohej nga Urdhri i Psikologut**. Me shkresë Nr,4 Prot, datë 08.01.2024 të gjitha komisariatet në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë janë informuar në lidhje me përditësimin e listës së psikologëve asistues për të miturit gjatë procesit të intervistimit nga ana e oficerit të policisë, si dhe psikologët e certifikuar si ekspertë asistues dhe vlerësues.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, punonjësit e policisë lajmëronin urgjencën dhe i shoqëronin ata në Qendrën Spitalore Universitare Nënë-Tereza Tiranë, për të marrë ndihmën mjekësore.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës të këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë. Avokati i Popullit thekson se posterat duhet të vendosen **brenda ambienteve** të dhomave të shoqërimit pasi përgjatë kalimit në korridor nuk garantohet leximi dhe kuptimi i tyre nga të shoqëruarit.

Gjithashtu konstatuam se në këtë komisarifat zbatohet praktika për pajisjen e personit të shoqëruar me kartën e të drejtave të personave të shoqëruar, që në momentin e shoqërimit në mjediset e këtij komisariati, kartat e të drejtave ishin të printuara dhe qëndronin tek zyra e oficerit të shërbimit.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave për ndërtimin e dhomave në Komisarifat e Policisë Nr.3 Tiranë të ndara më vete *për gratë, meshkujt madhorë dhe të miturit*, sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”* i ndryshuar, dhe procedurës standarde dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë

19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim.

2. Marrjen e masave për ndërtimin e tualeteve të ndara më vete për gra dhe burra sipas parashikimeve në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. nr.894, datë 19.07.2022.
3. Marrjen e masave për rikonstruksionin e dhomës për të shoqëruarit në moshë madhore dhe sigurimin e kushteve të përshtatshme të qëndrimit në të.
4. Marrjen e masave të menjëhershme, për marrjen në dorëzim dhe vënien në funksionim të ambientit për intervistim e të miturve në konflikt me ligjin, dhe nxjerrjen e përgjegjësive ndaj punonjësve të cilët nuk kanë marrë masa për vënien në funksion të këtij ambienti ndonëse i përfunduar prej 5 vitesh.
5. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin më vete të zyrës ku merren në pyetje personat e shoqëruar si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera brenda saj, për monitorimin e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.
6. Marrjen e masave për vendosjen e posterave me të drejtat e personave të shoqëruar, **brenda ambienteve** të dhomave të shoqërimit pasi përgjatë kalimit në korridor nuk garantohet leximi dhe kuptimi i tyre nga të shoqëruarit.
7. Marrjen e masave për të siguruar ujë të pijshëm dhe vakt ushqimor nëse qëndrojnë për një kohë të gjatë brenda ambienteve të komisariatit.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

AHMET PREÇI